

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike të iniciuar me padinë e paditësit [REDACTED] me adresë në Ferizaj rr [REDACTED] p.n, kundër të paditurës [REDACTED] nga Ferizaj rr [REDACTED] p.n, për shkak të vërtetimit të pronësisë, jashtë seancës gjyqësore me datë 08.01.2019 merr këtë:

A K T G J Y K I M

-Në bazë të pohimit-

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj, dhe **VËRTETOHET** se paditësi [REDACTED] nga Ferizaj, është pronar i vetëm i njësisë kadastrale nr.P-72217092-03130-4 në sipërfaqe prej 1118 m² e cila gjendet në vendin e quajtur "Sherret" Zona Kadastrale Ferizaj, Komuna Ferizaj.
- II. **DETYROHET** e paditura [REDACTED] nga Ferizaj, që paditësit [REDACTED] t'ia pranojë të drejtën e pronësisë dhe t'ia lejojë regjistrimin e të njëjtës në regjistrat kadastral, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me forcë.

A r s y e t i m i

Paditësi me datë 22.11.2018 ka ushtuar padi kundër të paditurës për vërtetimin e të drejtë së pronësisë në bazë të marrëveshjes gojore të shitblerjes.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka obliguar palën e paditur që të parashtron përgjigje në padinë e paditësit.

E paditura brenda afatit të paraparë ligjor ka paraqitur përgjigje në padinë e saj, përmes së cilës ka deklaruar se burri i saj sa ishte gjallë, në vitin 1999 i'a ka shitur paditësit pronën objekt kontesti e cila është evidentuar me numrin dhe sipërfaqen si në padi. Poashtu, e paditura në përgjigjen e saj në padi ka theksuar se e ka pranuar në tersi çmimin e shitblerjes



në shumën prej 85,000.00 DM tani në vlerë (42.500 euro), paditësi i cili ka hyrë në posedim të ligjshëm të pronës, në të cilën ka ndërtuar shtëpi dhe deri më tani e ka në shfrytëzim të qetë e të papenguar nga askush. Mëtej, e paditura në përgjigjen e saj në padi ka theksuar se, duke qenë se në mes nesh nuk ka asgjë kontestuese sa i përket kësaj pronë, i propozoj gjykatës që pa caktuar seancë, të nxjerrë aktgjykim në bazë të pohimit të kërkesëpadisë dhe t'a bartë të drejtën e pronësisë nga e paditura [REDACTED] në emër të paditësit [REDACTED]

Gjykata, pas analizimit të përgjigje në padi, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit nuk është kontestuese nga e paditura dhe njëherit kërkesëpadia nuk është në kundërshtim me faktet dhe provat e paraqitur nga paditësi dhe të pohuara nga e paditura, andaj gjykata si përfundim ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në tersi dhe e njëjta duhet të aprovohet si e bazuar.

Nga të lartë cekurat, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, bazuar në nenin 148 të LPK-së.

Shpenzimet e procedurës janë bazuar në nenin 450 të LPK-së.


GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI CIVIL

C.nr.1141/18 më dt.08.01.2019

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më Dana 08 / 01 / 2019



Gjyqtarja
Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesë, në afat prej 15 dite, nga dita e shpalljes së Gjykatës së Apelit të Prishtinës, përmes kësaj Gjykate.